

SHTOJCA A - "Formulari i aplikimit"

Drejtuar

CSI Piemonte

Lënda: STUDIM TREGU PËR PËRZGJEDHJEN E OPERATORËVE EKONOMIKË QË DO TË FTOHEN PËR TË PARAQITUR OFERTË PËR SHËRBIMET NË KUADRIN E PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT AT 17 IPA JH 01 19 NË SHQIPËRI

Unë, i nënshkruari, _____, lindur në _____

më ____/____/____, me adresë të përhershme _____ në cilësinë e

përfaqësuesit ligjor të Operatorit Ekonomik _____

me seli në _____ Shteti _____

Identifikimi i taksave dhe nr. I TVSH _____

(në vijim "Deklaruesi")

DEKLAROJ

Interesin për pjesëmarrje në këtë studim tregu dhe në mënyrë të veçantë për:

◆ Shërbim katering: pushim kafeje për 2 aktivitete që do të zhvillohen në Tiranë si pjesë e projektit në periudhën nga Janari deri në Shtator 2021;

◆ Shërbim interpretimi dhe shërbim përkthimi: interpretim simultan dhe konskutiv nga anglishtja/italishtja drejt gjuhës shqipe gjatë aktiviteteve të projektit dhe seminareve; shërbim përkthimi të dokumenteve të projektit nga anglishtja/italishtja/gjermanishtja drejt shqipes dhe anasjelltas. Shërbimi i interpretimit mund të duhet të kryhet nga distanca nëpërmjet platformës së video konferencës. Shërbimet duhen ofruar në periudhën nga janari deri në shtator 2021;

◆ Shërbim printimi dhe lidhjeje të dokumentacionit të projektit. Shërbimi duhet ofruar në periudhën nga janari deri në shtator 2021;

◆ Shërbim i dizajnit të identitetit vizual të Projektit dhe furnizimi me pajisje kancelarie të personalizuar. Shërbimi duhet të kryhet në përputhje me Udhëzuesin e Komunikimeve të BE-së¹ dhe do të përmbajnë logot e projektit, BE-së dhe partnerëve; duhen kryer në të dy gjuhët zyrtare të projektit (anglisht dhe shqip) dhe duhen ofruar në periudhën nga janari deri në shtator 2021.

Për këtë qëllim, unë, Deklaruesi, i identifikuar si më lart:

¹ https://ec.europa.eu/international-partnerships/comm-visibility-requirements_en

DEKLAROJ

Në emër të dhe për llogari të Operatorit Ekonomik:

(Nëse Operatori Ekonomik është i vendosur në Itali)

- Se kam lexuar me kujdes njoftimin e këtij studimi tregu dhe se pranoj plotësisht përmbajtjen e tij;
- Se zotëroj të gjitha autorizimet sanitare, higjienike, mjedisore, të sigurisë të kërkuara nga legjislacioni aktual për shërbimin/shërbimet për të cilin/cilat paraqitet aplikimi;
- Se jam i regjistruar në regjistrin e Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë të _____, nr. REA _____, kategoria _____ nga (data) _____ (nëse "Operatori Ekonomik" është i vendosur në Itali);
- Se qoftë Operatori Ekonomik, ashtu edhe anëtarët e Organit Drejtues, Menaxhues, Mbikëqyrës që ushtrojnë kompetencat e përfaqësimit, vendimmarrjes apo kontrollit në lidhje me operatorin, nuk kanë pengesa për të kontraktuar me Administratën Publike sikurse përcaktohet në nenin 80 të Dekretit Legjislativ nr. 50/2016;
- Se kam kryer në 3 vitet e fundit shërbime të ngjashme në sasi dhe përmbajtje me atë/ato për të cilat paraqitet aplikimi. Është e nevojshme të tregohet për secilin shërbim të paktën 1 kontratë që specifikon datën, objektin, sasinë dhe klientin;
- Se jam i vetëdijshëm që në rast mungese edhe të vetëm një kriteri, aplikuesi nuk do të ftohet të paraqesë ofertë për shërbimin/shërbimet e përcaktuara në aplikim.

(Nëse Operatori Ekonomik nuk është i vendosur në Itali)

- Se kam lexuar me kujdes njoftimin e këtij studimi tregu dhe pranoj plotësisht përmbajtjen e tij;
- Se zotëroj çdo autorizim sanitar, higjiene, mjedisor dhe sigurie të kërkuar nga legjislacioni i Shtetit në të cilin është i vendosur operatori ekonomik dhe në lidhje me shërbimin/shërbimet për të cilin/cilat paraqitet aplikimi;
- Se jam i regjistruar tek _____, kategoria _____, nga (data) _____ (informacionin përkatës të plotë në lidhje me organin ekuivalent të Dhomës Italiane të Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë sipas legjislacionit në vendin e origjinës);
- Të mos gjendet në një nga situatat në vijim:
 - o Është i falimentuar, nënshtruar likuidimit, apo procedurave të mbylljes, asetet e tij janë duke u administruar nga një likuidator apo nga një gjykatë, është në një marrëveshje me kreditorë, aktivitetet tregtare janë pezulluar, ose është një çdo lloj situatë analoge që rrjedh nga një procedurë e ngjashme e përcaktuar sipas Bashkimit apo legjislacionit ose rregulloreve kombëtare;
 - o Është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë se personi është në shkelje të detyrimeve të tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me ligjin e zbatueshëm;

- o Është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim administrativ të formës së prerë se personi është fajtor për shkelje të rëndë profesionale pasi ka shkelur ligjet ose rregulloret e zbatueshme, ose normat etike të profesionit të personit, ose për shkak se ka kryer çdo lloj shkeljeje që ka ndikuar në kreditibilitetin e tij profesional, kur një sjellje e tillë tregon qëllim të padrejtë, ose neglizhencë të rëndë, përfshirë, në mënyrë të veçantë, një nga të mëposhtmet:
 - (i) mashtrim ose keqinterpretim nga pakujdesia të informacionit të kërkuar për verifikimin e mungesës së arsyeve për përjashtim ose të përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes apo në zbatimin e një kontrate apo marrëveshjeje;
 - (ii) Lidhje marrëveshjeje me persona të tjerë, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës;
 - (iii) Shkelje e të drejtave të pronësisë intelektuale;
 - (iv) Përpjekje për të ndikuar procesin e vendimmarrjes së një autoriteti kontraktues gjatë procedurës së përzgjedhjes së fituesit;
 - (v) Përpjekje për të marrë informacione konfidenciale që mund t'i japin atij përparësi të padrejta në procedurën e përzgjedhjes fituesit;
- o është përcaktuar me vendim të formës së prerë se personi është fajtor për një nga të mëposhtmet:
 - (i) *mashtrim, sipas kuptimit të nenit 3 të Direktivës (BE) 2017/1371 dhe nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiarë të Komuniteteve Evropiane hartuar me Aktin e Këshillit të 26 korrikut 1995;*
 - (ii) *korrupsion, sikurse përcaktohet në nenin 4(2) të Direktivës (BE) 2017/1371 ose korrupsion aktiv sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës mbi luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, hartuar me Aktin e Këshillit të 26 majit 1997, ose sjellje sikurse referohet në nenin 2(1) i Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/JHA, ashtu si edhe korrupsion sikurse përcaktohet në ligjet e tjera të zbatueshme;*
 - (iii) *sjellje në lidhje me një organizatë kriminale, referuar nenit 2 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/841/JHA ;*
 - (iv) *pastrim parash dhe financim të terrorizmit, sipas kuptimit të nenit 1(3), (4) dhe (5) të Direktivës (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;*
 - (v) *vepra terroriste ose vepra të lidhura me aktivitete terroriste, sikurse përcaktohet në nenin 1 dhe 3 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA, përkatësisht, ose nxitjen, ndihmën, mbështetjen ose tentimin për të kryer vepra të tilla, sikurse referohet në nenin 4 të atij Vendimi;*
 - (vi) *shfrytëzim i punës së fëmijës ose vepra të tjera në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, sikurse referohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;*
- o çdo vendim i formës së prerë që ka vërtetuar mangësi të konsiderueshme në zbatimin e detyrimeve kryesore në zbatimin e një kontrate apo marrëveshjeje të financuar nga buxheti i Bashkimit, e cila ka çuar në përfundimin e saj të parakohshëm ose në aplikimin e pagesës së zhdëmtimit ose penaltiteteve të tjera kontraktuale, ose të cilat janë zbuluar pas kontrolleve, auditimeve, apo hetimeve

nga autoriteti kontraktues, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) ose Gjykata e Auditorëve;

- o është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim administrativ të formës së prerë se personi ka kryer parregullsi sipas kuptimit të nenit 1(2) të Rregullores së Këshillit (EC, Euratom) nr. 2988/95;
- o është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë se personi ka krijuar një njësi në një juridiksion të ndryshëm me qëllim për të shmangur detyrimet fiskale, shoqërore, ose çdo lloj detyrimi tjetër ligjor të juridiksionit ku është e regjistruar zyra e tij, administrata qendrore, apo vendin kryesor të biznesit.
 - të ketë zhvilluar në 3 vitet e fundit shërbime të ngjashme në sasi dhe përmbajtje me atë/ato për të cilat po depozitohet aplikimi. Është e rëndësishme të tregohet për secilin shërbim të paktën një kontratë ku të specifikohet data, objekti, sasia dhe klienti.
 - Të jetë i vetëdijshëm se në rast mungese të vetëm një prej kritereve, aplikanti nuk do të ftohet të paraqesë ofertë për shërbimin/shërbimet e paraqitura në aplikim.

(Vendi dhe data)

OPERATORI EKONOMIK

(nënshkrimi)

Bashkëlidhur një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit (Kartë identiteti, Pasaportë).